


**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 18.08.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragash

02 m. b. 409/01-15248/25  
18.08.2025  
Dragash - Dragash

**PROCESVERBAL**

Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra,vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.)

Për Buxhetin e vitit 2026

I mbajtur më 11.08.2025 (e hënë)

**VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra,vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.) për Buxhetin e vitit 2026 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 24.07.2025.

**Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:**

Shqip: <https://www.opshina-dragash.gov.ki/2025/07/24/dendjeve-buxhetore-2026/>

Boshnjakisht: <https://www.opshina-dragash.gov.ki/2025/07/24/dendjeve-buxhetore-2026/>

**Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:**

Shqip: <https://www.facebook.com/opshina.dragash/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/opshina.dragash/>

**Njoftimi në uebfaqen zyrtare: <https://www.opshina-dragash.gov.ki/2025/07/24/dendjeve-buxhetore-2026/>**

<https://www.opshina-dragash.gov.ki/2025/07/24/dendjeve-buxhetore-2026/>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në ora 11:00 dhe ka përfunduar në ora 11:50.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **30 pjesëmarrës, prej tyre 15 meshkuj dhe 15 femra**. Kryetari i Komunës së Dragashit, z.Bexhet Xheladini, e bëri hapjen e këtij takimi dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë dëgjim buxhetor.

**Bexhet Xheladini:** Siç e dini, buxheti komunal nuk është buxhet i kryetarit të Komunës. Ne jemi organizatë shpenzuese. Është buxhet i qytetarëve të Komunës së Dragashit, dhe për këtë qëllim ne sot jemi mbledhur me ju, që ta diskutojmë buxhetin e vitit 2026, me i marrë qëndrimet, propozimet, kërkesat e juaja. Siç e dini, Ministria e Financave e ndan buxhetin e komunave në bazë të disa kriterëve. Unë po i përmendi disa nga to. Kriteri kryesor është numri i banorëve. Ne me regjistrimin e fundit të popullsisë kemi pësuar një rënie të numrit të banorëve, nga 34 mijë në 28,896 banorë. Në këtë mënyrë, ne kemi buxhet të alokuar vetëm në raport me këtë lartësi të popullsisë. Gjithashtu, buxheti komunal ndahet edhe në bazë të sipërfaqes së komunës, pastaj përqindjes së minoriteteve, numrit të nxënësve, numrit të shkollave, numrit të çerdheve, numrit të objekteve shëndetësore etj. Kryetari i Komunës, bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin mbi Kufijtë Administrativë të Komunave, organizon debat publik me qytetarë, për të marrë propozimet nga qytetarët për hartimin e buxhetit dhe propozimin e buxhetit për Asamble Komunale, që unë si kryetar i Komunës jam i obliguar që kryesueses së Kuvendit t'ia paraqes buxhetin para datës 1 shtator. Kështu që, ne me data jemi në rregull, kemi kohë me u përgatit dhe kemi kohë që para datës 1 shtator buxheti i propozuar nga kryetari i Komunës t'i dorëzohet kryesueses së Kuvendit, në mënyrë që kryesuesja e Kuvendit më datën 4 shtator ta ketë edhe një debat me KPT-në, për të shkuar pastaj buxheti përfundimisht për miratim në Asamblenë Komunale. Siç e dini, buxheti i Komunës sonë për vitin e ardhshëm është 13,254,881€. Granti për Arsim është 4,700,000€; Granti për Shëndetësi është 1,661,000€; Granti për Investime Kapitale është 4,000,000€; për Shpenzime Komunale 400,000€; dhe për Subvencione 400,000€. Nga Subvencionet, 90 mijë euro i kemi parashikuar të shkojnë në Zyrën e Kryetarit; 100 mijë euro për Bujqësi; 150 mijë euro për Kulturë, Rini dhe Sport; dhe 60 mijë euro për bursa. Nga i gjithë ky buxhet, për Paga do të shkojnë afër 7 milionë euro; për Mallra dhe Shërbime 1.5 milionë euro; për Shpenzime Komunale 400 mijë; dhe për Subvencione 400 mijë. Marrë në përqindje, 52% e buxhetit të Komunës shkon për paga; 12 % për Mallra dhe Shërbime; nga 3% për Shpenzime Komunale dhe Subvencione; dhe 30% për Investime Kapitale. Për fillim, nuk dua t'ju lodh më shumë, ia kisha kaluar fjalën drejtorit të Buxhetit.

**Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim:** Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kryetari në përgjithësi pothuajse e bëri përshkrimin. Mua më duhet të ju sqaroj se pse ne jemi tubuar sot këtu dhe cila është rëndësia e pjesëmarrjes tuaj në këtë dëgjim buxhetor. Përveç transparencës, shumë me rëndësi është që prioritetet e juaja të kenë afatin e vet kohor që ne mund t'i parashohim në buxhet në seancën e fundit vjetore, kur edhe bëhet miratimi i buxhetit, gjithashtu bëhet edhe miratimi i projekteve të cilat parashihen në këtë buxhet. Prandaj, edhe pse jemi në një vit specifik, për arsye se edhe KAB-in të cilin e kemi miratuar në Kuvendin Komunal, nuk është miratuar KASH-i nga Qeveria, për arsye të ndryshme që nuk është konsoliduar Kuvendi i Kosovës. Gjithashtu, Ministria e Financave nuk e ka dërguar edhe Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila do të ishte pjesë e diskutimit, për faktin se presim që në Qarkoren e Dytë Buxhetore të kemi edhe një shtim të buxhetit, një vlerë të mjaftueshme që do të kishim mundur të shpërndanim për investime kapitale në Komunën tonë. Por, përkundër të gjitha këtyre vështirësive, ne kemi arrit, falë kryetarit edhe stafit në përgjithësi, që të bëjmë listën e prioritetëve. Gjithashtu, edhe Kuvendit Komunal të Dragashit, i cili e ka miratuar KAB-in, dhe i kemi bërë projeksionet për vitin 2027 dhe 2028. Mirëpo, e rëndësishme është sot që, pasi e bëri përshkrimin kryetari, të jemi pak më konkretë edhe ta kursejmë kohën, të shkojmë me propozime konkrete, që të na jepni ju si qytetarë propozimet, të cilat do të ulemi t'i shqyrtojmë përsëri me Grupin Punues për Buxhet dhe do të shohim se sa do të kenë hapësirë që vitin tjetër t'i futin për implementim në këto projekte. Prandaj unë nuk dua t'ju marr shumë kohë, do të kisha pas dëshirë që ta hapim debatin edhe të merrni ju fjalën dhe ju të flisni sot më shumë, për arsye se ne e quajmë dëgjim buxhetor, është me rëndësi me ju dëgjue juve se çfarë po na propozoni. Dhe, si Grup Punues për Buxhetin, të shohim bashkë me kryetarin se cilat projekte që ju i parashihni me prioritet t'i inkorporojmë. Unë nuk dua t'ju marr kohë që t'ju lexoj projektet të cilat i kemi paraparë, sepse mendoj se stafi jua ka ndarë të gjithëve nga një listë të projekteve. Ata të cilët e kanë lexue, e shohin vetveten dhe interesin, mund ta lexojnë edhe ta shohin këtu. Por, në qoftë se nuk janë të përfshira projektet këtu, mund të propozojnë edhe projekte të reja, sepse kemi mundësi ligjore që deri në miratimin e buxhetit në seancën e fundit të bëjmë edhe ndryshime eventuale, në qoftë se i shohim që janë si propozime të arsyeshme. Prandaj, unë mendoj se, për mos me humb kohë, t'ua japim fjalën drejtpërdrejt pjesëmarrësve që janë këtu.

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit, drejtor! Siç e dini, faza e dytë e dëgjimeve buxhetore është me grupe më pak të përfaqësuar, duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen e komunitetit joshumicë, pastaj e kemi edhe shefin e Zyrës së Komuniteteve, e kisha lut që ta marrë fjalën!

**Uzair Hamza, shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim:** Përshëndetje! Dua ta shfrytëzoj rastin, si shef i Zyrës për Komunitete, t'u dëshitoj punë të mbarë Kabinetit dhe kryetarit të cilët e kanë përpiluar këtë Listë të shpenzimeve kapitale. Në këso raste, unë bëj thirrje që të vijnë edhe përfaqësuesit e fshatrave, e sidomos nga komunitetet, që ata këtu t'i paraqesin kërkesat e banorëve, e sidomos kur janë edhe pjesa dërmuese e diasporës në pushime këtu. Është shumë me rëndësi që propozimet e përfaqësuesve të fshatrave të jenë në kuadër të vendeve ku ata jetojnë. Përfaqësuesit e komunitetit të jenë më afër qytetarëve, t'i shohin ato rrugë, të bëjnë parkingje, sidomos kah ana e Gorës ku janë rrugët e ngushta dhe nuk kanë kapacitete për parkimin e veturave, duhet të shihet një alternativë tjetër diku. Dhe ne, si përfaqësues duhet të kujdesemi për ata, për banorët e atyre fshatrave, sidomos kur vijnë diaspora këtu. Në këtë rast është edhe problemi i rrymës. Kryetari dhe drejtori e thanë që ky është një buxhet sa i përket mjeteve financiare, mirëpo kërkesat munden që të ndryshohen ndërkohë, si vijnë prej banorëve. Faleminderit shumë!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! E kisha lut edhe kryesuesen e Kuvendit që ta marrë fjalën!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë! Siç e ceki edhe kryetari, pasi të bëhen këto dëgjime buxhetore, kryetari i Komunës ma drejton mu për me pranue buxhetin dhe për me e qi në Kuvendin e Komunës së Dragashit. Unë kisha dashtë ma shumë prej juve me pas kërkesa, siç kemi pas kërkesa vitin e kaluar, si për PAPA TESTIN, subvencionimin për kancerin e gjirit dhe disa të tjera. Unë pres nga ju që të keni më shumë kërkesa. Dëgjimi tjetër që ka me u mbajt, që e kryesoj unë, ka me qenë më 4 shtator, nga KPF-ja, dhe aty do të merren të gjitha kërkesat dhe do të qiten në buxhet të Komunës për vitin 2026-2028. Atëherë, faleminderit kryetar, faleminderit edhe ju të gjithë të pranishëm! Pres kërkesat e juaja, që kryetari bashkë me stafin t'i qet në buxhet! Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! Dua ta falënderoj shërbimin e Kuvendit i cili ua ka shpërndarë të gjithë të pranishmëve propozimet e KAB-it, sa u përket investimeve kapitale. Mirëpo, duke marrë parasysh se këto informata i keni vetëm ju, dhe këtu i kemi edhe mjetet e informimit, do të keni pak durim që këto propozimet që i kemi dhënë dhe që i ka miratuar Asambleja Komunale në KAB, unë do t'i lexoj, në mënyrë që qytetarët të jenë të njoftuar me propozimet tona dhe, në rast nevojë, ata pastaj mund të na drejtohen neve edhe me shkrim, për ndonjë projekt të cilin ata kanë nevojë me e bo. Unë po filloj me i lexuc të gjitha ato projektet të cilat i kemi paraparë në periudhën e ardhshme me i realizue.

Faleminderit për vëmendjen! Tash është fjala për ju!

**Shaqir Skeraj, përfaqësues i komuniteti me nevoja të veçanta:** Përshëndetje për të gjithë! Ju urj për punën e dëritanishme dhe suksese në të ardhmen! Po, sa e lexova qatë që nuk po më pëlqen mu, deponia në fshatin Rrenc, ajo nuk do të bëhet, duhet ta gjeni një vend tjetër, ku ta shihni më të

arsyeshme. Dhe e dyta, e kam bërë një kërkesë unë, për personat me aftësi të kufizuar, ose me e ndërrue zyrën, ose me pas qasje me e rregullue zyrën për personat me aftësi të kufizuar. Faleminderit!

**Munir Jonuzi, asambleist dhe përfaqësues i fshatit Rapçë:** Përshëndetje për të gjithë! Ky është leximi i parë i buxhetit. Ju utoj sukses në drejtimin e qytetit tuaj dhe të realizoni gjithçka që keni planifikuar. Sot do të flas si përfaqësues i fshatit Rapç dhe në këtë fjalim do të përqendrohem vetëm te fshati ynë. Në projektbuxhetin për vitin 2025 për fshatin Rapç janë ndarë rreth 95,000 euro për infrastrukturën rrugore. Natyrisht, kjo është propozuar nga Këshilli i fshatit dhe ne si përfaqësues të fshatit kemi propozuar që këto fonde të ndahen për këtë projekt. Megjithatë, gjatë dhjetë ditëve të fundit, kur kishte më shumë përqendrim të popullsisë, ne mbajtëm një takim me banorët. Në këtë takim u dhanë shumë propozime për fshatin Rapçë, kështu që, natyrisht, nuk mund të realizojmë gjithçka në vitin 2026. Tani është në dorë të Bordit të fshatit të vendosë se në cilat investime kapitale do të shpenzohen këto 95,000 euro. Ne, pasi ende nuk kemi mbajtur takimin e Bordit të fshatit, do t'i propozojmë në formë të shkruar se cilat investime kapitale duhet të realizohen në vitin 2026. Dëshitoj të tërheq vëmendjen edhe për bashkëpunimin me këshillat e fshatrave dhe projektin me emrin „Hapja e rrugës Zadrit dhe ndërtimi i infrastrukturës tjetër për nevojat e fshatit Rapçë“. Ky projekt duhet të realizohet në vitin 2025 dhe u miratua vitin e kaluar. Më intereson të di deri ku ka shkuar ky projekt. A janë bërë matjet fillestare dhe paramasat për projektin „Hapja e rrugës Zadrit“ në Rapçën e Poshtme? Ndoshta zyrtarët e urbanizmit kanë qenë në Rapçë, por nuk janë takuar me përfaqësuesit e Këshillit të fshatit, kështu që nuk kam informacion nëse matjet janë kryer. Duke qenë se tenderi ende nuk është shpallur, besoj se nuk janë kryer. Nëse jo, ju lutem, zoti kryetar, dërgoni sa më shpejt zyrtarët tuaj që të bëjnë së paku matjet fillestare. Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** E falënderoj përfaqësuesin e fshatit Rapçë për konstruktivitetin që e tregoi dhe për propozimet që i dha! Presim së shpejti që nga fshati Rapçë t'i marrim propozimet në formë të shkruar sa i përket investimeve kapitale që do të bëhen në këtë fshat, në vlerën e parashikuar 95 mijë euro.

**Xhyfërie Bahtijari Beqiri, asambleiste:** Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket adresimit të problemeve të grave në Komunën tonë, mendoj se duhet t'i qasemi problemit pak më rrënjësisht, ngase, që t'i realizojmë disa kërkesa të grave, së pari duhet t'i dëgjojmë ato. Dhe, për t'i dëgjuar gratë nga e gjithë Komuna jonë, është pak e vështirë t'i sjellim në Kuvendin Komunal të Dragashit, duke e pas parasysh pozitën gjeografike që objekti i Kuvendit Komunal e ka, sidomos – dua të theksoj –

paksa larg pjesës së Opojës. Dhe, për këtë arsye, do të kërkoja nga kryetari që kërkesën për zonën e Opojës, të realizojmë një vendtubim, një objekt ku mund t'i ftojme gratë pak më lehtë, paksa i ngjashëm me vendtubimin që e kemi formuar këtu në Dragash, Qendrën e tubimit të grave. Aty më lehtë mund t'i marrim kërkesat dhe nevojat e grave. Përveç tjerash, këtë objekt mund ta shfrytëzojmë edhe për kurse të ndryshme, ngase kemi interesim nga shumë organizata të ndryshme, që të realizohen kurse të llojeve të ndryshme për gra dhe fëmijë. Kërkesa e dytë të cilën do ta plasoj në këtë dëgjim buxhetor, është kërkesa për mahallën "Te Xhamia" në fshatin Zaplluxhe, për një kënd lojëtarësh në këtë lagje. Faleminderit! Besoj që kërkesat tona do të merren parasysh dhe së shpejti të realizohen!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! Besoj që këto kërkesa do të merren parasysh dhe janë kërkesa të realizueshme.

**Lindita Kozmaqi Piraj, zyrtare për Barazi Gjinore:** Përshëndetje për të gjithë! Jam në cilësinë e zyrtares për Barazi Gjinore, edhe zëri i të gjitha atyre grave dhe vajzave të cilat nuk janë prezente këtu, dhe jo vetëm grave, por edhe burrave e djemve, sepse synojmë të drejta të barabarta në të drejtat e njeriut. Përveç që e mbështes këtë kërkesën e Xhyllferies që ta kemi një qendër ku mbajmë trajnime apo ngritje të kapaciteteve për profesione të ndryshme, t'u jepet mundësi aty ku është komuniteti më i përqendruar. Sigurisht Bresana shfrytëzohet si një qendër e vogël, me fshatra përreth kur gratë e kanë më të lehtë qasjen. Po ashtu, kësaj kërkesë i bashkëngjitet edhe kërkesa e krahutshme e grave nëpër takime të ndryshme ku ato vijnë dhe i kemi prezente: kërkesa për një punësim. Punësimi i vetëm është aty ku ato kanë mundësi të ngritin kapacitetin e tyre, të mendojnë për një biznes të ardhshëm, apo edhe t'u lehtësohet përmes Komunës, në hapjen e ndonjë minifabrike, në të ardhmen, në Opojë, po pse jo edhe në Dragash dhe grave të komunitetit joshumicë. Por, për me realizue këtë kërkesë, për me iu dalë në ndihmë Komuna, kemi edhe një kërkesë të krahutshme dhe evidente, të cilën e kemi bashkëbisedu edhe vitin e kaluar, edhe me kryetarin, edhe me kryesuesen, që është kërkesa e transportit. Siç e dini, Komuna e Dragashit përballet me mungesë të transportit ndërrurban dhe transport publik. Fshatrat e të dyja trevave, si të Opojës, si të Gorës, me qendrën e Dragashit, dhe po ashtu Dragashi me Prizrenin. Përveç kërkesave që kanë qenë e grave të punësuar, që e kanë një problem të madh të lëvizin, Dragash-Prizren dhe anasjelltas, po ashtu edhe të gjitha ato gratë të cilat duan të vijnë në Dragash, të jenë prezente madje edhe në këtë takim, kanë probleme me transportin e tyre, kur dihet se jemi pak Komunë me një konfiguracion të ashpër, me shpërndarje bukur të madhe të fshatrave, dhe në anën tjetër kemi linja shumë të pakta që lidhin fshatrat e ndryshme me Dragashin dhe anasjelltas. Siç e dimë, vitin e kaluar Rrjeti i Grave ka filluar një hulumtim dhe tash këtë javë e ka përfunduar, bile më ka bërë ftesë të jem pjesëmarrëse në përmblyllje me 1 shtator, në panel në Prishtinë.

Ë ka bo projektin për hulumtimin e transportin të Prishtinës dhe Dragashit, duke e përfshi se jemi komunë multietnike, me gorano-boshnjak, ndër komunat e vetme në Kosovë. Po ashtu, edhe për problematikën që e kemi, siç e theksova, të këtyre faktorëve më herët. Të shohim, ndoshta ka mundësi që në të ardhmen, në bashkëfinancim me Komunën, ndoshta me ndonjë donator apo edhe ministria, t'i shpeshtojmë linjat e autobusëve dhe t'u mundësohet lëvizja më e lehtë grave dhe vajzave, sepse në përgjithësi komunitetit i lehtësohet, por kur jemi tek çështja e pozitës së grave, është pak më e vështirë, për arsye se kemi mungesë të automjeteve më pak se burrat, dhe për mënyrën që burrat mund të dalin dhe të presin, e t'i marr dikush, ndërsa për gratë kjo paraqit një problematikë shtesë dhe krijon vështirësi shumë më të mëdha në integrimin e tyre në shoqëri, duke fillu prej pjesëmarrjes nëpër takime që e kemi qendrën në Dragash, që e kemi bashkëfinancu Komuna me ASB-në, dhe i mbajmë takimet e rregullta me tema të ndryshme që kanë të bëjnë me ngritjen e vetëdijes dhe realizimin e të drejtave të grave dhe vajzave, ku gjithmonë pjesëmarrja e tyre është problem, dhe atëherë kur ato vijnë me një takim e shprehin këtë shqetësim, se për fat të keq transporti nuk na mundëson meqenëse jemi të interesuara me marrë pjesë nëpër këto takime dhe me qenë të integrueme. Kjo besoj se e bën lehtësimin e tyre, edhe të asaj kërkesës për punësim, kur kemi një transport më të sigurt, ato nisin edhe shprehin interesimin edhe për punësim, në Dragash apo me një fshat tjetër. Po ashtu, si kërkesë e imja do të ishte edhe mbështetje edhe për një vit për analizën e PAPA TESTIT të grave, duke konsideruar se është një analizë që e diagnostifikon dhe parandalon kancerin e mitrës që është mjaft i përhapur te gratë. Nuk e di qysh ka shku pjesa e kësaj mbështetje me PAPA TESTI gjatë këtij viti dhe sa ka qenë interesimi, por duke e pas parasysh se është viti i parë, sigurisht se është interesimi më i vogël. Mirëpo, besoj se interesimi vjen e rritet. Dhe, për mbështetjen financiare për gratë e prekura me kancer, duke e pas parasysh pozitën e tyre në shoqëri, numrin e vogël të grave të punësuara dhe të pavarësuara ekonomikisht, sadopak, edhe pse kjo mbështetje është shumë simbolike, për fat të keq, për shkak të numrit të shpenzimeve që kërkon trajtimin. Por, sadopak Komuna t'u del në ndihmë atyre kërkesave. Ka kërkesa të shumta të grave të prekura, fatkeqësisht. Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! Sa i përket kërkesës së transportit brenda Komunës, unë e di që kjo kërkesë është që disa vite duke u përsërit, edhe në qeveritë e kaluara. Por, është pak vështirë e realizueshme, për shkak të arsyeshmërisë ekonomike që kompanitë të cilat merren me këtë punë nuk duan ta kryejnë, për shkak të llogarive. Sa i përket transportit Dragash-Prizren dhe anasjelltas, unë i kam bërë të gjitha përpjekjet, të gjitha përgatitjet, të gjithë dokumentacionin e kam përgatit. Kam bërë edhe memorandum me kryetarin e Prizrenit. Ata na kën lejue neve, që ne mund të shpallim tenderin si Komunë dhe me fillue transportin Prizren-Dragash dhe anasjelltas. Ka që dy vite e gjysmë që e kam

dërguar të gjithë dokumentacionin në Ministri të Transportit dhe Telekomunikacionit. Mund të ju them, së paku ndoshta një 30 herë i kam thirrë në telefon, kam biseduar, edhe një tri herë kam qenë vetë personalisht, edhe nuk kanë thënë kurrë jo – bëhet, bëhet, do të kryhet – edhe deri sot nuk kemi asnjë përgjigje. Besoj që unë do të bëj përpjekje edhe një herë, ta shoh mos po mund ta gjej një zgjidhje. Nuk ka kurrfarë pengese ligjore, pasi që Prizreni e ka lejuar, por pse nuk po e bëjnë një gjë të tillë, nuk e di. A është duke penguar dikush nga këtu, apo çka është problemi nuk e di, por kjo është informata e saktë që po e jap unë për këtë çështje. Sa i përket PAPA TESTIT, ka me vazhduar për çdo vjet. Ka me u mbështetur prej Komunës. Unë jam edhe me profesion mjek, edhe pse në tash pas dy muajve i kemi zgjedhjet, por në projektin tim do ta paraqes se PAPA TESTI do të jetë i vazhdueshëm deri sa të jem unë kryetar, besoj që edhe kushdo që vjen duhet ta vazhdojë një gjë të tillë. Sa i përket mbështetjes së grave të cilat vuajnë nga kanceri i gjirit, ne si Kuvend Komunal e kemi kryer pagesën e të gjitha grave të cilat kanë aplikuar dhe kanë dëshmuar me dokumentacion që vuajnë nga kanceri i gjirit. Pa marrë parasysh a janë mjekuar a jo, të gjitha grave u kanë dalë mjetet në xhirrollogaritë e tyre. Gjithashtu, i kemi subvencionuar edhe të gjitha gratë të cilat vuajnë nga kanceret tjera. Shuma është më e vogël sesa kanceri i gjirit – për kancerin e gjirit ju e dini që janë subvencionuar deri në 500 euro – por edhe gratë me lloje të tjera të kancerit janë subvencionuar me nga një shumë pak më të vogël. Kështu që, këto kërkesa do të vazhdojnë – edhe nëse do të ketë edhe kërkesa tjera, sa i përket subvencionimit, nëse këto i miraton Asambleja Komunale, unë si kryetar edhe ne si qeveri komunale jemi të obliguar t'i zbatojmë.

**Beqir Beqaj, përfaqësues nga fshati Bellobrad:** Përshëndetje për të gjithë! Jam këtu në cilësinë e përfaqësuesit të Bellobradit, sepse kjo pjesë e komunikimit me publikun dhe kërkesat publike, jam ngarkuar që t'i parashtoj unë, prandaj edhe dola. S'kam shumë, pak sqarime më shumë dua. Tek pika e 5-të kemi rehabilitimin e infrastrukturës rrugore në Komunën e Dragashit. Tani, po bëhet fjalë për qytezën e Dragashit, apo për Komunën si tërësi? Dhe, nëse përgjigja është që për Komunën si tërësi, prapë ka kërkesa të shumta që rruga e vjetër ekzistuese, të ndërhyhet aty sa më parë, në mënyrë që të shmangen – siç kam thënë edhe herët e kaluara – shumë dukuri jo të mira. Dhe, po që se u funksionalizua ajo rrugë, shumëkë do të jetë më mirë, si për Bellobradin, por edhe kur po ka bllokada – isha dëshmitar para ca dite, kur u bllokua rruga qendrore të shkollës – po të ishte ajo rruga do të vazhdonin tutje dhe pa problem do ta kishin edhe qarkullimin. Pavarësisht se nuk ka të bëjë kjo pika e 29-të me Bellobradin, veç desha t'ju them se ju e përmendet, apo këtu është e shkruar në Brut, domethënë, hapja e rrugës kah Likeni dhe fusha, si dhe kubëzimi i rrugëve qendrore në fshatin Brut. Mos është në Breznë, po them?! Edhe tek pika e 30-të, ndërtimi i rezervarit të ujit mbi zabel, bëhet fjalë për Bellobradin. A do ta mbulojë të gjithë vendbanimin aty? Sepse, jo rastësisht po i bëj këto

pyetje, se dikush po thotë që për një pjesë do të jetë. Prandaj, është mirë të ketë edhe sqarime. Tek Arsimi dhe Shkenca, pika e 3-të, rehabilitimi i stadiumit në SHFMU "Sezai Surroi" në Bellobrad. Nëse ka mundësi, pak sqarime, çfarë do të rehabilitohet? Edhe në fund, e vetmja kërkesë që është, me trotuaret. Siç nuk kam rreshtur së kërkuari ndriçimin publik, dhe ja që u desh të angazhoheni ju më në fund dhe ta kemi ndriçimin publik, jo vetëm në Bellobrad, por e gjithë Komuna tani po shkëlqen faktikisht me këtë ndriçim, që është punë shumë e mirë – kur e kërkoja para ca viteve, shumëkush më ka shikuar sikur s'di çfarë po kërkoj. Por, ja që qenka e realizueshme kur ka vullnet për të vepruar. Pra, siç kam kërkuar me vite të tëra ndriçimin publik, njëjtë po kërkoj për Bellobradin trotuaret. Ka shumë vende ku mund të rregullohen trotuaret dhe të bëhet lëvizja më e lirë për këmbësorët. Kaq kishat Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! Sa i përket rehabilitimit të rrugëve, është fjala për rrugët në pjesën e Opojës, ku ne do t'i ndajmë 180 mijë euro, do ta shpallim një tender trevjeç, dhe tash më nuk do të presim me shpallë tenderë me humb kohë, por do ta bëjmë një marrëveshje me një kompani që do ta fitojë tenderin, dhe aty ku priset rruga menjëherë me intervenue. Këtu është fjala edhe për rehabilitimin e rrugëve, kubëzave të vjetra, aty ku janë prish rrugët – do të merret më shumë me riparime. Trotuaret, do të vijnë në radhë edhe ata. Nuk është problem, siç ka ardhë radha edhe e ndriçimit publik. Për rrugën e vjetër të Bellobradit, shumë herë e di që je duke e përmend. Besoj që mandatin e ardhshëm kjo mund të realizohet, por kemi kërkesa pak më akute. Për shembull, rrugët lokale, infrastruktura, pastaj ujësjellësi, kanalizimi etj. Por, edhe asaj sigurisht që do t'i vijen radha. Sa i përket Shqipër Skerajt, janë kërkesa të realizueshme. Sa i përket deponisë, është fjalë për mbetje të ngurta, jo të amvisërisë. Këtë nuk e ka bo kjo qeveri, por kjo është në PZHK, është në 'kushtetutën' e Komunës. Nuk e ka bërë Bexhet Xheladini këtë. Por, është me PZHK e paraprë në atë vend. Ne bile kemi dashtë me e bo në tjetër vend, Ministria nuk na ka miratue, ka thënë e keni të paraparë me PZHK në atë vend. Ai vend nuk e ndot ambientin, nuk është fjala për me pru mbetje organike me gjujt aty. Është fjala për mbetje ndërtimore, të cilat në fund mbulohen me dhe, edhe ajo lugina që është e paraparë ka me u mbulue edhe ka me u duk ma bukur. Sa i përket kërkesës për zyrë, ne jemi në fillim të ndërtimit të një objekti i cili quhet qendër multifunkionale. Këtu bash në qendër, ku është ish-DKA. Tenderi është shpallë, është shpallë fituesi, do të kushtojë 1 milion euro. Aty do të ketë zyra të mjaftueshme edhe për shoqatën tuaj. Kështu që, kur të ndërrohet ajo, mjafton vetëm me e bo kërkesën edhe do ta ndajmë edhe për ju një zyrë. Do të mundohemi që ta bëjmë atë në katin e parë, nëse ka mundësi, por nëse nuk ka mundësi, kjo ka me pas edhe ashensor, kështu që, edhe nëse vendoset nëpër katet tjera, nuk do të jetë problem për personat me nevoja të veçanta. Dua ta shfrytëzoj këtu edhe një herë rastin që t'i drejtohem qeverisë në detyrë, që të gjithë personave, bizneseve, ekonomive familjare,

të cilët kanë pësue dëme nga vërshimet e fundit, e kisha lut qeverinë në detyrë që ta bëjë sa më shpejt pagesën e tyre, ministri në detyrë i Financave që ta bëjë një gjë të tillë, për arsye se i gjithë dokumentacioni i nevojshëm, i kompletuar, është në Ministrinë e Financave dhe pret vetëm një nënshkrim për t'ua lëshuar këtyre të dëmtuarve këto mjete. Edhe nesër, po ashtu, kemi edhe një debat publik me qytetarë, siç e kemi sot, por me grupe tjera të interesit. Prandaj, e shfrytëzoj rastin që, përmes mjeteve të informimit, t'u bëj thirrje që nesër, në ora 11:00, këtu në këtë sallë të vijnë dhe të marrin propozime edhe nga ata. Bëhet fjalë për klube të ndryshme, OJQ, fermerë, biznese etj., që të vijnë këtu nesër, është debati i fundit publik i kryetarit me qytetarë. Debati i fundit, si takim, është edhe i kryesueses së Kuvendit me KPF-në, pastaj për ta çuar përfundimisht buxhetin në miratim, në shator të këtij viti, për në Asamble Komunale. Ju faleminderit për pjesëmarrjen!

**Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:**

**Në uebfaqe:**

Shqip: <http://www.dergjimi-buxhetor.com>

Boshnjakisht: <http://www.dergjimi-buxhetor.com>

**Në Facebook:**


Shqip: <https://www.facebook.com/dergjimi-buxhetor>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/dergjimi-buxhetor>

**SHTOJCË: Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Data/Datum: 11.08.2025

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

**LISTA E PJESËMARRRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME GRUPE TË**  
**NËNPËRFAQËSUARA (GRA, VAJZA, PËRFAQËSUES TË**  
**KOMUNITETIT JOSHUMICË, PENSIONISTË, PERSONA ME NEVOJA**  
**TË VEÇANTA ETJ.)**

**LISTA UÇESNIKA NA BUDŽETSKO SASLUŠANJE SA NEDOVOLJNO**  
**ZASTUPLJENIM GRUPAMA (ŽENE, DEVOJKE, PREDSTAVNIKE I**  
**NEVEĆINSKE ZAJEDNICE, OSOBE SA POSEBNIM POTREBAMA ITD.)**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Vendbanimi   | Etnia              | M | F | Nënshkrimi |
|-----|------------------|--------------|--------------------|---|---|------------|
| Br. | Ime i Prezime    | Prebivalište | Etnička pripadnost | M | Ž | Potpis     |
| 1   | Semira Misini    | Shajne       | Shqiptare          |   | F |            |
| 2   | Amir Berberi     | Dragash      | Shqiptare          |   | F |            |
| 3   | Esra Qelagaj     | Dragash      | Shqiptare          |   | F |            |
| 4   | Eina Berberi     | Dragash      | Shqiptare          |   | F |            |
| 5   | Leonida Misini   | Shajne       | shqiptare          |   | F |            |
| 6   | Shaban Shkenderi | Banë         | -                  | V |   |            |
| 7   | SLAD TO SUT,     | RAPSA        | BOSHIK             | V |   |            |
| 8   | YBER MELECI      | BLAQ         | SHQIPTAR           | V |   |            |
| 9   | SHAFIR ZEBER     | ERENI        | SHQIPTAR           | V |   |            |
| 10  | Zahira Drosingj  | Dragash      | Shqiptare          |   | V |            |
| 11  | Adem Enin        | Shajne       | Shqiptar           | V |   |            |
| 12  | Merybe Khamadini | Zapiluxhe    | Shqiptar           |   | V |            |
| 13  | Refmedina Haxhi  | Dragash      | Shqiptare          |   | V |            |
| 14  | LINDITA PIRRI    | Dragash      | Shqiptare          |   | V |            |
| 15  | Shufte Berberi   | Dragash      | Shqiptar           |   | V |            |
| 16  | ARBIT KAMBERI    | KOSOVE       | Shqiptar           | V |   |            |
| 17  | Mehmet Shkenderi | KUR          | SHQIPTAR           | V |   |            |
| 18  | Lirim Harisani   | Blag         | Shqiptar           | V |   |            |
| 19  | RESHAT ALIDA     | BLAQ         | SHQIPTAR           | V |   |            |
| 20  | Isa Bajrami      | Shajne       | Shqiptar           | V |   |            |
| 21  | Zahide Haxhi     | Shajne       | Shqiptare          |   | V |            |
| 22  | Era Adem         | Besicave     | Shqiptar           | V |   |            |
| 23  | Faq Kalloni      | Kosove       | Shqiptar           | V |   |            |

REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA  
 Komuna e Dragashit  
 Opština Dragaš

02 Nr. B. 400/01-15248/25  
 M.O.P. 20.25  
 Dragash - Dragaš

|    |                  |          |           |   |    |                  |
|----|------------------|----------|-----------|---|----|------------------|
| 24 | Mimpic Benishia  | Blice    | gligptare |   | F  | U. P. Benishia   |
| 25 | Nimic Benishia   | Liraash  | gligptare |   | F  | Nimic Benishia   |
| 26 | MYZEREIE OAELESH | BELBOSHO | gligptare |   | F  | MYZEREIE OAELESH |
| 27 | Mynir Janus      | Lajia    | basnjak   | M | 10 | Mynir Janus      |
| 28 | Qermit Kollan    | Oreja    | gligptare | M |    | Qermit Kollan    |
| 29 | Uzesh Hamza      | Kostec   | Bosnjak   | M |    | Uzesh Hamza      |
| 30 | Arijeta Gheray   | Krenc    | gligptare | Q | F  | Arijeta Gheray   |
| 31 |                  |          |           |   |    |                  |
| 32 |                  |          |           |   |    |                  |
| 33 |                  |          |           |   |    |                  |
| 34 |                  |          |           |   |    |                  |
| 35 |                  |          |           |   |    |                  |
| 36 |                  |          |           |   |    |                  |
| 37 |                  |          |           |   |    |                  |
| 38 |                  |          |           |   |    |                  |
| 39 |                  |          |           |   |    |                  |
| 40 |                  |          |           |   |    |                  |
| 41 |                  |          |           |   |    |                  |
| 42 |                  |          |           |   |    |                  |
| 43 |                  |          |           |   |    |                  |
| 44 |                  |          |           |   |    |                  |
| 45 |                  |          |           |   |    |                  |
| 46 |                  |          |           |   |    |                  |
| 47 |                  |          |           |   |    |                  |
| 48 |                  |          |           |   |    |                  |
| 49 |                  |          |           |   |    |                  |
| 50 |                  |          |           |   |    |                  |
| 51 |                  |          |           |   |    |                  |
| 52 |                  |          |           |   |    |                  |
| 53 |                  |          |           |   |    |                  |
| 54 |                  |          |           |   |    |                  |
| 55 |                  |          |           |   |    |                  |
| 56 |                  |          |           |   |    |                  |
| 57 |                  |          |           |   |    |                  |
| 58 |                  |          |           |   |    |                  |
| 59 |                  |          |           |   |    |                  |
| 60 |                  |          |           |   |    |                  |
| 61 |                  |          |           |   |    |                  |
| 62 |                  |          |           |   |    |                  |
| 63 |                  |          |           |   |    |                  |
| 64 |                  |          |           |   |    |                  |
| 65 |                  |          |           |   |    |                  |
| 66 |                  |          |           |   |    |                  |
| 67 |                  |          |           |   |    |                  |
| 68 |                  |          |           |   |    |                  |
| 69 |                  |          |           |   |    |                  |

